

**Të huajt në Shqipëri**  
Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure  
(ESMS)  
INSTAT

**Metadate Referenciale**

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse .....	4
5. Periudha e referencës .....	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti .....	5
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	6
11. Manaxhimi i cilësisë .....	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	8
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor .....	10
19. Komente.....	10
Aneks .....	10

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Popullsisë, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Olta Caca
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës në Sektorin e Statistikave të Popullsisë
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë.
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:ocaca@instat.gov.al">ocaca@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / 240
1.8. Numri i faksit	+355 (4 ) 228 300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	22.12.2021
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	22.12.2021
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	22.12.2021
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat mbi “Të huajt në Shqipëri” merr në konsideratë çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.</p> <p>Qëllimi i publikimit vjetor i të huajve në Shqipëri është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas grupmoshave dhe gjinisë, arsyes së aplikimit, vendeve të origjinës si dhe numrin vjetor të aplikimeve të lejeve të qëndrimit. Publikimi gjithashtu paraqet dhe të huajt e parregullt.</p> <p>Seritë e të dhënave mbi të huajt përmbajnë informacion statistikor mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës</li> <li>• Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas gjinisë</li> <li>• Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas grupmoshës</li> <li>• Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas arsyes së aplikimit</li> <li>• Të huajt e parregullt</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas kontinenteve</li> <li>• Aplikimet për leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës</li> <li>• Aplikimet për leje qëndrimi në Shqipëri sipas afatit të qëndrimit</li> </ul>
<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p>Klasifikimi i shtetësisë bazohet në listën e kodeve ISO-3166 (duke përdorur alfa-2) me ndryshime të vogla.</p> <p>Këto ndryshime konsistojnë në ndryshime të vogla që kanë ndodhur me kalimin e kohës për të pasqyruar krijimin e vendeve të reja ose shtetësive. Në disa raste, këto kategori të shtetësisë nuk janë të njohura botërisht, por përdoren dhe njihen nga Shqipëria.</p>
<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>Informacioni statistikor mbulon të dhënat për të huajt me leje qëndrimi sipas vendit të origjinës, arsyes së aplikimit, kontinenteve, gjinisë, grupmoshës, të huajt e parregullt si edhe aplikimet për leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p><b>I huaj</b> është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.</p> <p><b>Leje qëndrimi</b> është dokumenti i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili autorizon dhe lejon të huajin të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve.</p> <p><b>Person pa shtetësi</b> është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.</p> <p><b>Leje pune</b> është autorizimi i lëshuar nga autoriteti shtetëror përgjegjës, një të huaji, për qëllime biznesi, për t'u punësuar, vetëpunësuar ose për formim profesional.</p> <p><b>Bashkim familjar</b> është hyrja dhe qëndrimi në Republikën e Shqipërisë të anëtarëve të familjes së një shtetasi shqiptar, të cilët nuk kanë shtetësinë shqiptare, ose të një të huaji, ose refugjati, banorë në Republikën e Shqipërisë, me synim ruajtjen e familjes, pavarësisht nëse marrëdhënia familjare krijohet para apo pas hyrjes së të huajit në Republikën e Shqipërisë, në rastet e bashkimit familjar të familjes së të huajit.</p> <p><b>Anëtarë të familjes së të huajit, azilkërkuesit, refugjatit apo personit nën mbrojtje plotësuese</b> janë bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesi/bashkëjetuesja, bashkëjetesa e të cilit ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar; të miturit, fëmijët e pamartuar, pjesë e përbërjes familjare, përfshirë dhe ata të vendosur në regjim të kujdestarisë dhe që janë në ngarkim të tij ose të saj apo të birësuar me vendim gjykate apo një vendimi që zbatohet drejtpërdrejt, sipas detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë ose që duhet të njihet, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, si dhe fëmijët e rritur, të pamartuar, kur ata nuk mundën objektivist të plotësojnë nevojat e tyre, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore; paraardhësit e shkallës së parë në linjë të drejtë, kur janë në ngarkim të tij, ose bashkëshortes/bashkëshortit, sipas legjislacionit të origjinës dhe nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e origjinës.</p>

	<p><b>Shërbimi vullnetar</b> është një program aktivitetesh solidarizuese, bazuar në veprimtari të njohura në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të objektivave të interesit të përgjithshëm.</p> <p><b>Studiues dhe specialistë</b> janë të huajt që kanë njohuri të specializuara, thelbësore, për shërbimin, pajisjet kërkimore dhe nivel të lartë kualifikimi për aktivitetin që ushtron ndërmarrja ose institucioni kërkimor.</p> <p><b>Qëndrim i parregullt</b> është prania në territorin e Republikës së Shqipërisë të një të huaji, i cili nuk plotëson, ose nuk plotëson më kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><b>Shtet apo vend i origjinës</b> është shteti, shtetësinë e të cilit mban azilkërkuesi apo refugjati dhe, në rastin e personave pa shtetësi, shteti në të cilin refugjati apo azilkërkuesi ka vendbanimin e tij të zakonshëm.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është individi.
3.6. Popullata statistikore	Statistikat e të huajve u referohen individëve të huaj me leje qëndrimi në Shqipëri si dhe të huajt e parregullt.
3.7. Zona e referencës	Territori i Republikës së Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Seritë kohore të të Huajve në Shqipëri publikohen çdo vit, duke filluar nga viti 2017 e në vazhdim. Të dhënat e agreguara janë në nivel vendi. Të dhënat janë të disponueshme nga viti 2005 dhe në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
<b>4. Njësia matëse</b>	Numër individësh.
<b>5. Periudha e referencës</b>	Ky raport i referohet vitit 2020.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore për prodhimin e treguesve Të huajt në Shqipëri, është pjesë e bazës ligjore të INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”</a></li> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021</a></li> </ul> <p>Konceptet statistikore dhe përkufizime bazohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr.79/2021 “Për Të Huajt”</a></li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Aktualisht nuk ka shkëmbim të dhënash në nivel Evropian.

<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura nga njësitë statistikore konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikën zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk u shpërndan palëve të treta të dhënat e mbledhura nga, apo tek të cilat ka akses, të dhëna këto që mund të shërbejnë në identifikimin drejtpërsëdrejti apo tërthorazi të njësive statistikore që i kanë ofruar të dhënat në fjalë për arsye dhe qëllime statistikore, apo të dhëna të vjela nga burime të tjera administrative. INSTAT ndërmerr tërë masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga Instituti i statistikave vetëm në rast se:</p> <p>a) këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor;</p> <p>b) njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave.</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i Institutit të Statistikave. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktuara shkallën e detajeve që mund të shpërdahet dhe të bëhet publike nga Instituti i Statistikave, me qëllim që të bëhet i pamundur identifikimi i njësisë statistikore nga këto të dhëna; kriteret e anonimizimit për të dhënat mikro që u ofrohen përdoruesve; dhënia e aksesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendarin e publikimeve	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	<p><a href="#">Kalendari</a> i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.</p>

8.3. Akses i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Website – online release;</li> <li>2. Kërkesat e shkruara;</li> <li>3. Publikimi;</li> <li>4. <a href="#">Kërkesa për të dhëna</a>, seksioni për përdoruesit e jashtëm.</li> </ol>
<b>9. Shpeshhtësia e shpërndarjes</b>	Statistikat për Të huajt në Shqipëri publikohen një herë në vit.
<b>10. Akses i të dhënave dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	<p>Sipas kalendarit të publikimeve, të dhënat për Të huajt në Shqipëri shpërndahen çdo vit me një publikim më vete, në data specifike. Publikimi mundësohet në faqen zyrtare të INSTAT, në bazën e të dhënave statistikore Pxweb, gjithashtu shpërndahen elektronikisht tek përdoruesit.</p> <p>Njoftimet dhe vonesat publikohen në kalendarin e publikimeve. Në rastin e vonesave, specifikohet data tjetër e botimit dhe shpjegimi i arsyeve të vonesave.</p>
10.2. Publikime	<p>Përdoruesit mund t'i gjejnë publikimet në faqen e internetit të INSTAT të organizuara nën temën:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Të huajt në Shqipëri</a></li> </ul>
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhëna më të detajuara për Të huajt në Shqipëri publikohen në faqen zyrtare të INSTAT: <a href="#">Databaza Statistikore</a> .
10.4. Akses i të dhënave mikro	Akses i të dhënave mikro nuk aplikohet.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <a href="#">Kontakt</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Të dhënat janë siguruar nga burime administrative. Një shpjegim i shkurtër rreth përkufizimeve dhe metodologjisë për statistikën e të huajve gjendet në faqen e INSTAT në seksionin lidhur me <a href="#">Metodologjinë</a> mbi Statistikat e Të huajt në Shqipëri.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Popullsisë dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat për Statistikat e Të huajt në Shqipëri për qëllime të brendshme.

11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës (kostos) të të intervistuarve. Kontrollat e cilësisë dhe vleftësimi i të dhënave janë veprime që kryen përgjatë tërë procesit. Stafi i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të indeksit, - të këtilla si mbledhja e të dhënave, kontrollat fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollat përfundimtare që shoqërojnë përllogaritjen e indeksit, - është i mirë trajnuar dhe me përvojën e duhur. Kjo i jep mundësinë stafit që të përftojë një pamje të plotë dhe në vijimësi rreth ndërmarrjeve dhe përgjegjësi të tyre.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Burimi i të dhënave për Statistikat e Të huajt në Shqipëri është administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.</p>
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Publikimi i të dhënave për të huajt kanë një përdorim të gjerë kryesisht për planifikimin e politikave bazuar në evidenca, sepse shifrat e të huajve përdoren për të analizuar një sërë treguesish social dhe ekonomik, nga përdorues të ndryshëm ndër të cilët më kryesorët janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qeverisja qendrore</li> <li>• Qeverisja lokale</li> <li>• Bota Akademike</li> <li>• Përdorues të zakonshëm</li> </ul> <p>Informacioni mbi nevojat e përdoruesve për të dhëna mbi të huajt, dhe perceptimet e tyre në lidhje me to matet në disa mënyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Klikimet (Page Views) e produktit përkatës në website-n e INSTAT</li> <li>• Takime me përdorues të ndryshëm duke lejuar ata të diskutojnë mbi kërkesat dhe nevojat e tyre</li> <li>• Kontakte me përdorues të cilët kontaktojnë individualisht sektorin e Statistikave të Popullsisë mbi kërkesat e tyre specifike, apo dërgojnë në INSTAT kërkesat e tyre lidhur me statistikatat për të huajt</li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me Statistikat e Migracionit dhe Integrimi i migrantëve për vitin 2020 janë rreth 9,265 klikime.</p> <p>Gjatë 2020 INSTAT ka kryer vërtetimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve</p>

	<p>nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave të Migracionit dhe Integrimi i Migrantëve është vlerësuar me 3.70 (74%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon cdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>								
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave për statistikën e “ Të huajt në Shqipëri ” për vitin 2020 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të parashikuara në Programin e Statistikave zyrtare (2017-2021). Shkalla e plotshmërisë së të dhënave të vitit 2020, për Të huajt në Shqipëri është 100%.</p>								
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>									
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton burimet përkatëse të të dhënave për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave nëse shihet i nevojshëm ose të konfirmohen në mënyrë zyrtare.</p>								
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.</p>								
<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e statistikave për Të huajt në Shqipëri janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 356 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 356 ditë). Periudha referuese e rezultateve Të huajt në Shqipëri është 31 Dhjetor 2020.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>12/22/2021</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>356</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e publikimit	12/22/2021	Afatet kohore	356		
Periudha referuese	12/31/2020								
Data e publikimit	12/22/2021								
Afatet kohore	356								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Statistikave për Të huajt në Shqipëri publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i të dhënave mbi “Të huajt në Shqipëri” për vitin 2020 është shtyrë me 124 ditë për shkak të vonësve të të dhënave administrative.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>8/20/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>12/22/2021</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>124</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e shpallur	8/20/2021	Data e publikimit	12/22/2021	Vonesa në kohë	124
Periudha referuese	12/31/2020								
Data e shpallur	8/20/2021								
Data e publikimit	12/22/2021								
Vonesa në kohë	124								

<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>	
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Statistikat për Të huajt në Shqipëri paraqiten në nivel vendi. Këto statistika janë të krahasueshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënat koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënave.
15.2. Krahasueshmëria kohore	Statistikat për të huajt në Shqipëri datojnë që nga viti 2005 referuar databazës statistikore, duke siguruar një krahasueshmëri të gjatë kohore prej 16 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=16).  Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu vlerësimi i serive kohore dhe trendi i tyre.
<b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b>	<p>Sektori i Statistikave të Popullsisë është pjesë e Drejtorisë së Statistikave Sociale. Stafi i përfshirë në procedurat e mbledhjes së të dhënave, kontrollit të të dhënave, përditësimit dhe mirëmbajtjes së statistikave punon me kohë të plotë dhe është si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përgjegjës 1 punonjës</li> <li>2. Specialistë 3 punonjës</li> </ol> <p>Sa i përket të dhënave nga burimet administrativ ato janë pa kosto. Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet INSTAT dhe Ministrisë së Brendshme krijojnë mundësinë e transmetimit të të dhënave pa kosto.</p>
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit për Statistikat e Të huajt në Shqipëri bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve</a></li> </ul>
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në rast se burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi Statistikat e Të huajt në Shqipëri do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e ardhshëm shoqëruar me një shënim shpjegues për përdoruesit.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi Të huajt për vitin 2020, subjekt i këtij raporti.</p>

<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	Për statistikat e të huajve burimi i të dhënave janë vetëm të dhëna administrative. Të dhëna mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri si dhe të huajt e parregullt sigurohen nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin. Referuar të dhënave mbi aplikimet për leje qëndrimi dhe lejeve të qëndrimit në territor, informacioni sigurohet nëpërmjet Regjistrit Elektronik për të Huajt (FER).
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave realizohet me frekuence vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat mbi Të huajt në Shqipëri janë të dhëna me burim administrativ. Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e indikatorëve dhe statistikave mbi Të huajt në Shqipëri për vitin 2020, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikës. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin është burimi kryesor i të dhënave për të gjitha treguesit që publikohen sipas këtij programi.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave u janë bërë kontrolle logjike dhe matematike. Këto kontrolle kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit që INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
<b>19. Komentë</b>	
<b>Aneks</b>	